

## KONTRATË THEMELIMI SHOQËRI E THJESHTË

Sot më datë 31/03/2021, bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me nenet 1074 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, "Ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe Ligjin 9723 dt. 03.05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" vendosën të themelojnë Shoqërinë e thjeshtë, në bazë të kushteve që vijojnë:

### PALËT

**Pala-1 "WHATCH CONSTRUCTION" sh.p.k.**, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë e regjistruar në Regjistrin Tregtar me Nipt M113190056V me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Ali Demi", ambientet e ish "Kombinati Poligrafik", Godinë 2 katëshe, me **Administrator Z.Enis Tufina**, i biri i Jusuf, shtetas Gjerman, shqipfolës, lindur në Tiranë, më 29.08.1973, banues në rr. "Gabriel – Von-Seidl Str.45 82031, Grunwald, Munich, Gjermani, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Gjermane me nr. CHPL0K7RJ, **përfaqësuar** me prokurë të përgjithshme datë 21.01.2021, zyrë noterie Albana Sh. Mahmuti, nga **Z.Rejan Keta**, atësia Gilmond, amësia Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Shyqyri Ishmi, Njësia Administrative Nr.2, Tiranë, lindur më datë 08.09.2000, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me letërnjoftim ID Nr.033382802 dhe Nr. Personal K00906060R, në cilësinë e **Përfaqësuesit**.

### DHE

**Pala -2 "HERAL 07" sh.p.k.**, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë e regjistruar në Regjistrin Tregtar më dt. 11.08.2019, NIPT L92014021B, me seli në adresën: Rruga "Ali Demi", Nr. 1004 ish kombinati Poligrafik godina 2 katëshe ngjitur me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, Tiranë, përfaqësuar nga **administratori Z. Hergys RRELI**, i biri i Hakiut dhe Lutfijes, lindur në Tiranë më 24.09.1981 dhe banues në Tiranë, rruga "Dhimitër Kamarda", nr.31, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me numër personal I10924042Q.

### Të dhëna fillestare:

Shoqëria "**Heral 07" sh.p.k** ka fituar të drejtat për zhvillimin me ndërtim mbi disa prona, në të cilat do të ndërtohen godina banimi dhe shërbimi.

Përkatësisht sipërfaqet e pronave janë:

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/57, Vol. 12, Fq.84, sipërfaqe 15.500.00 m<sup>2</sup>

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/67, Vol. 37, Fq.217, sipërfaqe 12.233.80 m<sup>2</sup>

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/38, Vol. 12, Fq.63, sipërfaqe 8.513.00 m<sup>2</sup>

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/30, Vol. 11, Fq.74, sipërfaqe 349.00 m<sup>2</sup>

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/19, Vol. 11, Fq.75, sipërfaqe 1.063.00 m2

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/37, Vol. 11, Fq.73, sipërfaqe 419.00 m2

Zona Kadastrale 8180 Nr. Pasurie 10/17, Vol. 11, Fq.83, sipërfaqe 1.075.80 m2,

në Rr."Ali Demi", Tiranë, pranë ish-Kombinatit Poligrafik sipas Kontratave të Sipërmarrjes me pronarët përkatës të trueajve.

Shoqëria "**Whatch Constructon**" sh.p.k është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Shqiptar që ka ndër të tjera për objekt të veprimtarisë së vet kryerjen e investimeve dhe zhvillimin e projekteve në fushën e ndërtimit gjithashtu ka kapacitetet financiare dhe fizike për zbatimin e projektit për zhvillimin dhe ndërtimin godinave të banimit dhe shërbimit.

Për sa më sipër palët bien dakord për formimin e shoqërisë së thjeshtë me objekt zhvillimin me ndërtim të pronave të cituara më sipër.

## NENI 1

### FORMA, EMRI DHE SELIA

Shoqëria do të mbajë emrin "**Sol Construction**" dhe do të ketë zyrën e saj qendrore në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Ali Demi", ambientet e ish "Kombinati Poligrafik", Godinë 2 katëshe,

Shoqëria tregtare "**Sol Construction**" do të ketë formën e Shoqërisë së thjeshtë.

Shoqëria mund të hapë zyra përfaqësimi, degë, filiale ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera, qoftë brënda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria do të përfaqësohet në çdo shkresë të saj nga vula dhe logo e saj.

## NENI 2

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë zhvillimi i pronave të cituara më sipër me anë të ndërtimit.

Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari të nevojshme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

## NENI 3

### KAPITALI

Kapitali në Shoqërinë "**Sol Construction**" të jetë në vlerën e 1.000.000 (një milion) Euro, i përbërë nga kontributi i Anëtarëve si më poshtë:

"**Whatch Construction**", administrator **Z.Enis Tufina**, i biri i Jusuf, shtetas Gjerman, lindur në Tiranë, më 29.08.1973, dhe banues në rr. "Gabriel – Von-Seidl Str.45 82031, Grunwald, Munich, Gjermani, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme, datë 21.01.2021, zyrë noterie Albana



Sh. Mahmuti, nga **Z.Rejan Keta**, atësia Gilmond, lindur në Tiranë më 08.09.2000 dhe banues në Rrugën: Shyqyri Ishmi, Tiranë, do të zotërojë 1 (një) kuotë në masën 51% të kapitalit të shoqërisë, përkatësisht në vlerën 510.000 (pesëqind e dhjetë mijë) Euro.

“**Heral 07**” sh.p.k përfaqësuar nga **Z. Hergys Rreli**, në cilësinë e **administratorit**, i biri i Hakiut, lindur në Tiranë më 24.09.1981, dhe banues në adresën rruga “Dhimitër Kamarda”, nr.31, do të zotërojë 1 (një) kuotë në masën 49% të kapitalit të shoqërisë, përkatësisht në vlerën 490.000 (katërqind e nëntëdhjetë mijë) Euro.

#### NENI 4

#### ORGANET DREJTUESE

Organet e Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Anëtarëve;  
Asambleja e Anëtarëve përbëhet nga “**Whatch Construction**” Sh.p.k dhe “**Heral 07**” Sh.p.k.
2. Administratori;  
Administratori i parë do të jetë **Z. Rejan Keta**, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 3 (tre) vite me të drejtë riemërimi.

#### NENI 5

#### ADMINISTRATORI DHE FUNKSIONET E TIJ

Palët bien dakord që Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Rejan Keta**, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 3 (tre) vite nga momenti i regjistrimit, me të drejtë riemërimi.

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë do të jenë por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:

- Të zbatojë politikën dhe qëllimin për të cilin po krijohet kjo Shoqëri.
- Të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshëm dhe standartet kontabël;
- Të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- Të përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë të cilat do të miratohen nga Asambleja e Ortakëve.
- Te punësojë dhe të shkarkojë punonjës sipas politikave të shoqërisë;
- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë së ortakëve.



Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve të shoqërisë.

Angazhimi i shoqërisë nga administratori me palë të treta do të jetë vetëm për qëllimin e realizimit të objektit të kësaj kontrate.

Administratori ka detyrimin të raportojë Asamblesë së Ortakëve zbatimin e qëllimit për të cilin po krijohet kjo shoqëri.

Cështje të tjera të parashikuara në Ligji apo statut.

## NENI 6

### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë fillon me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët dhe përfundimi lidhet drejtpërdrejtë me realizimin e objektit për të cilin po formohet kjo shoqëri .

## NENI 7

### PËRGJEGJËSIA

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë e “**Sol Construction**”. Ata mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

Ortakët marrin përsipër realizimet e të drejtave dhe detyrimeve, të cilat janë të caktuara në të gjitha kontratat e sipërmarrjes që ka lidhur shoqëria “Heral 07” sh.p.k, në proporcion me përqindjet e zotëruara në këtë shoqëri.

## NENI 8

### VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtim bën viti i parë, i cili fillon në datën e regjistrimit në Tatime, paisja me NIPT-in, deri më 31 dhjetor të po atij viti.

## NENI 9

### PRISHJA. LIKUJDIMI

Shoqëria do të priset në përfundim të realizimit të qëllimit për të cilin po krijohet ose në marrëveshje midis ortakëve me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të aksionerëve pa patur nevojën për zgjedhje të një likujdatori, me përjashtim të rastit kur palët do të drejtohen gjykatës për prishjen e kësaj shoqërie.

Shoqëria do të shpërndahet me marrëveshje mes palëve në bazë të një marrëveshje për ndarje të barabartë të të drejtave në raport me kuotat që zotëron secili pjestar.

## NENI 10

### NJOFTIMET

Palët në këtë kontratë do të njoftohen rregullisht në adresat e selive të tyre respektive të përcaktuara në këtë Kontratë Themelimi ose në Regjistrin Tregtar të Shoqërive.

Përvec formës së mësipërme, palët do të pranojnë njoftime edhe në adresat respektive të e-mailit:

- 1.
- 2.

## DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 11

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet ortakëve të kësaj Shoqërie, palët do ti drejtohen Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

### NENI 12

Për sa nuk është parashikuar në këtë Kontratë do të aplikohen ligjet "Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 Kodi CIVIL dhe Ligji 9723 dt. 03.05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Kontrata hartohet në 3(tre) kopje në gjuhën shqipe me të njëjtën fuqi ligjore dhe pasi Palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, nënshkruhet pa vërejtje dhe vuloset nga përfaqësuesit e tyre:

"HERAL 07" sh.p.k  
Administrator

Hergys RRELI

  


"WATCH CONSTRUCTION" sh.p.k  
Administrator Enis TUFINA

Përfaqësuar me prokure të përgjithshme nga

Rejan KETA

  
Rejan Keta  
RK14

